

Përmbledhje

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2014 u karakterizua me aktivitet më të ngadalësuar ekonomik. Sipas vlerësimeve preliminare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), norma reale e rritjes së PBB-së në Kosovë ishte 0.9 përqind, që është dukshëm më e ulët se sa në vitet e kaluara. Normë pozitive të rritjes ekonomike për vitin 2014, por më të ulët krahasuar me rritjen e vitit paraparak sugjerojnë edhe vlerësimet e BQK-së, ndërsa parashikimet për vitin 2015 sugjerojnë rritje të përshpejtuar ekonomike prej 3.5 përqind.

Çmimet kanë vazhduar të shënojnë rënie. Gjatë gjysmës të parë të vitit 2015, norma mesatare e deflacionit ishte 0.4 përqind (0.4 përqind inflacioni në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar).

Spektori fiskal gjatë gjysmës së parë të vitit 2015 u karakterizua me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Sa i përket të hyrave buxhetore, është shënuar rritje më e lartë e të hyrave vendore, përderisa në kuadër të shpenzimeve, rritja e kategorisë së pagave e mëditjeve dhe kategorisë së subvencioneve e transfereve ka ndikuar që shpenzimet e përgjithshme qeveritare të shënojnë rritje të konsiderueshme krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Spektori bankar deri në qershor 2015 është karakterizuar me rritje vjetore të përshpejtuar të aktivitetit kreditor prej 6.1 përqind (3.5 përqind në qershor 2014). Në anën tjetër, depozitat shënuan rritje më të ngadalshme vjetore prej 6.3 përqind (10.0

përqind në qershor 2014), kryesisht si pasojë e rënies së theksuar të normës së interesit në depozita. Normat e interesit në kredi dhe depozita kanë vazhduar të ndjekin trend rënës edhe gjatë vitit 2015. Mesatarja e normës së interesit në kredi në qershor 2015 ishte 7.6 përqind, ndërsa mesatarja e interesit në depozita ishte 0.8 përqind. Spektori bankar gjithashtu u karakterizua me përmirësim të cilësisë së portofolit kreditor, ku në qershor 2015 pjesëmarrja e kredive jo performuese në gjithsej kreditë u zvogëlua në 7.2 përqind (8.2 përqind në qershor 2014). Niveli kapitalizimit dhe i likuiditetit të spektorit është përforcuar akoma më shumë në qershor 2015 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraparak.

Deri në qershor të vitit 2015, spektori i jashtëm është karakterizuar me rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale. Rritja e deficitit të llogarisë rrjedhëse në gjashtëmuorin e parë të vitit 2015 kryesisht i atribuohet rritjes së deficitit në tregtinë e mallrave dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarisë së shërbimeve dhe të ardhurave parësore dhe dytësore. Deri në qershor 2015, eksportet shënuan rritje prej 14.5 përqind, përderisa importet u karakterizuan me rritje prej 5.1 përqind. Aktiviteti ekonomik në gjysmën e parë të vitit 2015 është mbështetur edhe nga dy burime të rëndësishme të rritjes ekonomike në vend, remitencat dhe IHD-të.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	i
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor	04
Ekonomia e Kosovës	06
Sektori Real	06
Sektori Fiskal	09
Sektori i Jashtëm	10
Sistemi Financiar	12
Sektori Bankar	12
Fondet Pensionale	20
Sektori Mikrofinanciare	22
Sektori i Sigurimeve	24
Tregu i Letrave me Vlerë	25
GRAFIKËT DHE TABELAT	04
Figura 1. Norma e kreditimit ndër bankar EURIBOR dhe norma e financimit e ECB-së	04
Figura 2. Çmimi i naftës "brent crude"	05
Figura 3. Çmimi i arit	05
Figura 4. Indeksi i çmimeve të ushqimit	06
Figura 5. Norma e këmbimit e euros	06
Figura 6. Rritja reale e PBB-së	07
Figura 7. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje	07
Figura 8. Lëvizja e çmimeve sipas komponentëve	08
Figura 9. Indekset e çmimit të konsumit, prodhimit dhe importit	08
Figura 10. Regjistri i bizneseve	09
Figura 11. Struktura e ndërmarrjeve të reja	09
Figura 12. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar	11
Figura 13. Remitencat	11
Figura 14. Struktura e investimeve të huaja direkte	12
Figura 15. Asetet e sistemit financiar në Kosovë	12
Figura 16. Asetet e bankave komerciale	13
Figura 17. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave	14
Figura 18. Vlerat dhe ndryshimet vjetore të kredive	14
Figura 19. Kreditë sipas sektorëve ekonomik	14

Figura 20. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik	15
Figura 21. Struktura e maturimit të kredive	15
Figura 22. Ndryshimi vjetor i depozitave në bankat komerciale	16
Figura 23. Struktura e depozitave në bankat komerciale	17
Figura 24. Struktura e depozitave sipas maturimit	17
Figura 25. Struktura e depozitave të afatizuara	18
Figura 26. Mesatarja e normave të interesit	17
Figura 27. Normat mesatare të interesit për kreditë e ndermarrjeve	17
Figura 28. Normat mesatare të interesit për kreditë e ekonomive familjare	19
Figura 29. Normat mesatare të interesit për depozita	19
Figura 30. Të hyrat dhe shpenzimet e bankave komerciale	20
Figura 31. Treguesit e profitabilitetit	20
Figura 32. NPL-të dhe provizionet për humbje nga kreditë	21
Figura 33. Rritja vjetore e gjithsej kredive dhe kredive jo performuese	21
Figura 34. Asetet e fondeve pensionale dhe rritja vjetore	21
Figura 35. Asetet e institucioneve mikrofinanciale	22
Figura 36. Struktura e kredive të institucioneve mikrofinanciare sipas maturitetit	23
Figura 37. Mesatarja e normave të interesit në kredi të institucioneve mikrofinanciare	24
Figura 38. Asetet e kompanive të sigurimit dhe rritja vjetore	25
Figura 39. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë	26
Figura 40. Norma e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit	26
Tabela 1. Treguesit e zgjedhur makroekonomik	28

SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (<i>angl. Capital Adequacy Ratio: CAR</i>)
CHF	Franku Zvicerran (<i>angl. Swiss Franc: CHF</i>)
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit (<i>angl. Consumer Price Index: CPI</i>)
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro (<i>angl. Euro currency</i>)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik (<i>angl. The Pound Sterling</i>)
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit (<i>angl. Index Price Index: IPI</i>)
NPL	Kreditë Jopërformuese (<i>angl. Non-Performing Loans: NPL</i>)
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (<i>angl. Return on Average Assets: ROAA</i>)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (<i>angl. Return on Average Equity: ROAE</i>)
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut (<i>angl. Risk Weighted Assets: RWA</i>)
USD	Dollari Amerikan (<i>angl. United States Dollar</i>)
WEO	World Economic Outlook


Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015, eurozona u karakterizua me ritëm të shpejtuar të rritjes së aktivitetit ekonomik. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ekonomia e eurozonës shënoi rritje prej 1.2 përqind (0.8 përqind në TM2 2014). Ndërsa, krahasuar me tremujorin paraprak, norma reale e rritjes ekonomike ishte 0.3 përqind (0.1 përqind në TM2 2014). Rritja e aktivitetit ekonomik e mbështetur kryesisht nga sektori i prodhimit dhe shërbimeve mbeti e koncentruar në Gjermani, Spanjë, Itali dhe Greqi, përderisa Franca u karakterizua me ngadalësim të rritjes ekonomike. Përkundër pritjeve për një rënie ekonomike prej 0.5 përqind, si pasojë e dështimit në pagesën e borxheve në afatin e paraparë, Greqia shënoi një rritje vjetore prej 1.4 përqind në tremujorin e dytë, ndërsa krahasuar me tremujorin paraprak, norma reale e rritjes ekonomike ishte 0.8 përqind. Aktiviteti ekonomik në Greqi vlerësohet të jetë mbështetur nga rritja e shpenzimeve të konsumatorëve gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015, nxitur nga pritjet për rritjen e kontrollit të kapitalit, si dhe nga rritja e të ardhurave nga turizmi.

Sipas BQE-së, eurozona u karakterizua me normë inflacioni prej 0.2 përqind në qershor 2015, duke tejkaluar periudhën deflacioniste të fundvitit 2014. Shkalla e inflacionit në eurozonë pritet të mbetet tejet e ulët në muajt në vijim, përderisa në fund të vitit 2015 pritet një ngritje graduale e shkallës së inflacionit. Për vitin 2015 në tërësi, FMN ka parashikuar një normë të inflacionit prej 0.1 përqind. Rritja graduale e shkallës së inflacionit pritet të nxitet kryesisht nga ndikimi i politikave lehtësuese

monetare në kërkesën e përgjithshme në eurozonë, ndikimi i normës së ulët të këmbimit të euros, si dhe pritjet për rritje graduale të çmimeve të naftës.

Figura 1. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e ECB-së



Burimi: Euribor (2014) dhe ECB (2014)

Në gjysmën e parë të vitit, pas lansimit të programit të lehtësimit sasior nga BQE, është vënë re një rikuperim i ekonomisë së eurozonës, përderisa zyrtarët e lartë të BQE-së kanë deklaruar se politikat e lehtësuara monetare do të plotësohen edhe me politika të planifikuara makro-prudenciale për të siguruar mirëmbajtjen e stabilitetit financiar.

BQE vazhdoi të mbaj të pandryshuar normën bazë të rifinancimit edhe në qershor 2015. Megjithatë, lansimi i programit të gjerë stimulues që nga marsi i këtij viti ka ndikuar në rënien e normave 1 mujore dhe 12 mujore të interesit të kreditimit ndërbankar Euribor. Në qershor 2015, normat 1 mujore të Euribor kanë rënë në mesatarisht -0.06 përqind nga -0.01 përqind në mars 2015. Në anën tjetër, normat mesatare për periudhën 12-mujore kanë shënuar rënie në mesatarisht 0.16 përqind në qershor 2015, nga mesatarja prej 0.21 përqind në mars 2014.

Performanca e aktivitetit ekonomik në Ballkanin Perëndimor në gjysmën e parë të vitit 2015 vlerësohet të ketë shënuar përmirësim. Rritja e aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2015 pritet të mbështetet kryesisht nga përforcimi i kërkesës së jashtme, që pritet të reflektohet në rritjen e eksporteve të vendeve në Ballkanin Perëndimor. Sipas parashikimeve të FMN-së, vendet në Ballkanin Perëndimor presin të shënojnë një rritje mesatare të PBB-së prej 2.8 përqind në vitin 2015. Mali i Zi pritet të karakterizohet me normën më të lartë të rritjes ekonomike prej 4.7 përqind, përderisa Serbia pritet të jetë vendi i vetëm që do shënoj një rënie ekonomike prej 0.5 përqind.


Vendet e Ballkanit Perëndimor në muajt e parë të vitit 2015 u karakterizuan me presione të dobëta inflacioniste, ndikuar kryesisht nga çmimet e ushqimit dhe energjisë në nivel global. Megjithatë, FMN parashikon një normë mesatare të inflacionit prej 1.0 përqind në vendet e regjionit për vitin 2015. Serbia pritet të karakterizohet me shkallën më të lartë të inflacionit prej 2.7 përqind, pasuar nga Shqipëria me 1.8 përqind, përderisa Maqedonia pritet të jetë vendi me shkallën më të ulët të inflacionit prej 0.1 përqind.

Çmimi ndërkombëtar i naftës

Çmimi i naftës (brent crude)¹ në tremujorin e dytë të vitit 2015 shënoj rënie prej rreth 43.4 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rënia më e madhe e çmimit të naftës është shënuar në janar 2015, ndërkohë që pritjet për vitin 2015

tregojnë për një rënie mesatare të çmimit të naftës prej 17 përqind kundrejt vitit 2014 (figura 2).


Figura 2. Çmimi i naftës 'brent crude', në USD për barel



Burimi: Banka Botrore (2015)

Me rënie të çmimit gjatë tremujorit të dytë u karakterizuan edhe metalet e arit (figura 3). Çmimi i arit ishte për mesatarisht 7.4 përqind më i ulët krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2014. Rënia më e madhe e çmimit të arit është shënuar në muajin mars 2015, ku 1 njësi ari (njësia matëse ekuivalente me 31.1 gram ari quhet “troy oz”) kanë kushtuar rreth 11.8 përqind më lirë se sa në muajin mars 2014.

Figura 3. Çmimi i arit, në USD për troy oz




Burimi: Banka Botrore (2015)

¹ 'Brent Crude' paraqet klasifikim tregtar për naftën e prodhuar në detin e veriut si përfaqësues i nivelit të çmimit të naftës në nivel global.

Trendi i rënies së çmimeve të ushqimit ka vazhduar edhe në tremujorin e dytë të vitit 2015. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, indeksi i çmimeve të ushqimit shënoi rënie prej mesatarisht 20.4 përqind, përderisa indeksi i çmimeve të drithërave shënoi rënie për mesatarisht 19.8 përqind (figura 4).


Figura 4. Indeksi i çmimeve të ushqimit dhe indeksi i çmimeve të drithërave



Norma e këmbimit të euros kundrejt valutave kryesore gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015 është zhvlerësuar kundrejt periudhës së njëjtë të vitit 2014. Zhvlerësimin më të madh euro e ka shënuar ndaj dollarit amerikan me 19.9 përqind, pasuar nga frangu zviceran me 14.9 përqind dhe sterlina britanike me 12.0 përqind.

Ndaj denarit maqedonas, euro ka mbetur pothuajse e pandryshuar në tremujorin e dytë kundrejt periudhës së njëjtë të vitit 2014, përderisa ndaj dinarit serb dhe lekut shqiptar ka shënuar vlerësim prej 4.1 përkatësisht 0.3 përqind. Euro u zhvlerësua edhe kundrejt kunës kroate gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015 për 0.2 përqind (figura 5).

Figura 5. Norma e këmbimit të euros



Ekonomia e Kosovës


Sektori Real

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2014 u karakterizua me aktivitet më të ngadalësuar ekonomik. Sipas vlerësimeve preliminare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), norma reale e rritjes së PBB-së në Kosovë ishte 0.9 përqind, që është dukshëm më e ulët se sa në vitet e kaluara (figura 6). Sipas vlerësimeve të ASK-së, vlera nominale e PBB-së në vitin 2014 arriti në 5.5 miliard euro. Vlerësimet e ASK-së bazohen në rritjen e konsumit dhe investimeve, përderisa neto eksportet konsiderohen të kenë ndikuar negativisht në rritjen ekonomike. Normë pozitive të rritjes ekonomike për vitin 2014, por më të ulët krahasuar me rritjen e vitit paraprak sugjerojnë edhe vlerësimet e BQK-së. Mirëpo, vlerësimet e BQK-së sugjerojnë se aktiviteti ekonomik është mbështetur kryesisht në rritjen e konsumit, përderisa investimet dhe neto eksportet vlerësohet të kenë kontribuar negativisht.

Dallimi kryesor në vlerësimet e dy insitucioneve qëndron tek komponenta e konsumit. Për dallim nga

ASK-ja, e cila ka vlerësuar se konsumi ka shënuar rritje prej vetëm 1.4 përqind, BQK-ja vlerëson se rritja e konsiderueshme e të gjitha burimeve të financimit të konsumit (kreditë e reja konsumuese, remitencat, pagat e sektorit publik dhe pensionet) kanë ndikuar në rritjen e kësaj komponente për 6.1 përqind.

Figura 6. Rritja reale e PBB-së, në përqindje



* Vlerësim preliminar i ASK-së

*Të dhënat për vitin 2015 paraqesin parashikimin e BQK-së


Burimi: ASK (2015)

Sa i përket investimeve, BQK-ja vlerëson se investimet në vitin 2014 u karakterizuan me rënie prej 7.6 përqind. Kjo rënie e investimeve kryesisht i atribuohet zvogëlimit të shpenzimeve për investime publike, përderisa investimet e sektorit privat regjistruan një rritje të lehtë. Pozicioni i neto eksportit gjatë vitit 2014 kishte ndikim negativ në rritjen ekonomike.

Për vitin 2015, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se ekonomia e Kosovës do të karakterizohet me përshpejtim të rritjes ekonomike, duke shënuar një normë reale të rritjes së PBB-së prej 3.5 përqind, e cila pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme. Konsumi, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, pritet që edhe gjatë vitit 2015 të ketë kontributin kryesor në rritjen ekonomike, por

me një shkallë më të vogël krahasuar me vitin paraparak. Në anën tjetër, investimet të cilat në vitin e kaluar vlerësohet të kenë shënuar rënie, gjatë këtij viti pritet të shënojnë rritje. Rritja e kërkesës së brendshme pritet të ndikojë në rritje të importit dhe, rrjedhimisht, në rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Ndërsa, llogaria financiare e bilancit të pagesave pritet të përmirësohet, kryesisht si rezultat i parashikimeve për rritje të investimeve të huaja direkte.

Figura 7. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2015)

Niveli i çmimeve në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (angl: Consumer Price Index: CPI), gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015 është karakterizuar me deflacion prej 0.4 përqind krahasuar me inflacionin prej 0.4 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (figura 7).

Gjatë tremujorit të dytë të vitit, komponentët e CPI-së si rryma, gazi dhe lëndët tjera djegëse shënuan rritje të çmimit për mesatarisht 4.5 përqind, pijet alkoolike dhe duhani 4.3 përqind dhe veshmbathja 1.7 përqind. Me rritje prej 0.7 përqind u karakterizuan edhe çmimet e ushqimit dhe pijet joalkoolike të cilat përfaqësojnë rreth 40.9 përqind të shportës së

konsumatorit kosovar (figura 8). Në anën tjetër, rënie më e theksuar e çmimeve u evidentua tek shërbimet e transportit për mesatarisht 6.6 përqind gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015. Rënia e çmimeve të shërbimeve të transportit i atribuohet kryesisht rënies së çmimit të derivateve të naftës.

Figura 8. Lëvizja e çmimeve sipas komponentëve, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2015)

Lëvizja e çmimeve në Kosovë është e ngjashme me lëvizjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importet. Kjo tregohet edhe nga sjellja e ngjashme e indeksit të çmimeve të importit me CPI-në (figura 8).

Çmimet e importit² në tremujorin e parë të vitit 2015 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak shënuan rënie mesatare prej 1.5 përqind. Në kuadër të çmimeve të importit, me rritje u karakterizuan çmimet e produkteve bimore, paisjet e makinerisë dhe paisjet elektrike, letra dhe artikujt e saj, artikuj të ndryshëm të prodhuar, etj. Ndërsa, çmimet e produkteve minerale, mjetet e transportit, artikuj të plastikës, etj., u karakterizuan me rënie gjatë tremujorit të parë të vitit 2015.

Figura 9. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Burimi: ASK (2015)


Indeksi i çmimeve të prodhimit në tremujorin e parë të vitit 2015 kundrejt tremujorit të parë të vitit 2014 shënoi rritje mesatare vjetore prej 3.6 përqind. Rritja e çmimeve ishte më e theksuar te energjia elektrike, gazi, etj., prodhimi i drurit dhe produkteve të drurit, prodhimi i produkteve kimike dhe prodhimi i pijeve. Në anën tjetër, rënia e çmimeve të prodhimit më së shumti ishte evidente te prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve, prodhimi i lëkurës dhe produkteve nga lëkura dhe prodhimi i letrës dhe produkteve nga letra.

Rënia e çmimeve në industrinë nxjerrëse dhe rritja e tyre në industrinë përpunuese është kryesisht rezultat i lëvizjeve në treg. Prodhimi industrial në vend, vlerësuar përmes indeksit të qarkullimit industrial, rezulton të ketë shënuar rritje të qarkullimit në sektorin e industrisë përpunuese në tremujorin e parë të vitit 2015 kundrejt periudhës së njëjtë në vitin paraprak (8.1 përqind). Në të njëjtën periudhë, indeksi i qarkullimit për industrinë nxjerrëse si dhe indeksi i qarkullimit për furnizimin me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar dhe furnizimin me ujë, veprimtari të menaxhimit dhe

² Bazuar në kalendarin e publikimeve të ASK-së indeksi i çmimeve të importit dhe prodhimit për tremujorin e dytë të vitit 2015 do të publikohet me 16 dhe 18 shtator 2015.

trajtim të mbeturinave ka shënuar rënie (43.7 përqind, 4.4 përkatësisht 7.6 përqind).


Figura 10. Regjistrimi i bizneseve, jo kumulative



Burimi: ASK (2015)

Sa i përket regjistrimit të ndërmarrjeve është shënuar rritje e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara dhe rënie e numrit të ndërmarrjeve të mbyllura. Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara në tremujorin e dytë të vitit 2015 ishte 2,487 që është për 88 ndërmarrje më shumë se sa në tremujorin e dytë të vitit 2014, ndërsa u mbyllën 435 ndërmarrje apo 10 ndërmarrje më pak se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 10).

Figura 11. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2015)

Edhe në tremujorin e dytë të vitit 2015 dominuan ndërmarrjet e regjistruara në tregti me 751

ndërmarrje të reja, prodhimitari me 261 ndërmarrje, bujqësi me 212 ndërmarrje dhe hoteleri me 263 ndërmarrje (figura 11). Kundrejt tremujorit të dytë të vitit paraprak, pothuajse të gjithë sektorët e rëndësishëm të ekonomisë është shënuar rritje e numrit të bizneseve të regjistruara me përjashtim të prodhimit, ndërtimtarisë dhe hotelerisë.

Sektori Fiskal

Të hyrat primare buxhetore³ deri në qershor 2015 arritën vlerën bruto prej 662.0 milionë euro. Nëse përjashtohen 15.0 milionë euro kthime të TVSH-së dhe tatimeve tjera nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës, atëherë të hyrat primare buxhetore shënojnë vlerën neto prej 647.0 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7.3 përqind. Në të njëjtën periudhë, shpenzimet primare buxhetore⁴ arritën vlerën prej 660.0 milionë euro që paraqet rritje prej 5.6 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rrjedhimisht, gjatë kësaj periudhe, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar prej rreth 13.0 milionë euro krahasuar me deficitin primar prej rreth 22.0 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Sa i përket strukturës së të hyrave buxhetore, vërehet rritje e të hyrave të mblledhura nga tatimet vendore të cilat arritën vlerën bruto prej 163 milionë euro. Nëse përjashtohen kthimet e administratës tatimore prej 14.0 milionë euro, atëherë të hyrat neto nga tatimet vendore shënuan rritje prej 12.9 përqind dhe arritën vlerën prej 149.0 milionë euro. Të hyrat e mblledhura

³ Në kuadër të të hyrave primare nuk janë përfshirë të hyrat nga huamarrjet, pranimet nga grantet e përgjithshme të donatorëve dhe pranimet e depozitave.

⁴ Në kuadër të shpenzimeve primare nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe kthimet nga fondet e depozitave.

nga tatimet kufitare arritën vlerën bruto prej 403.0 milionë euro që janë për 5.2 përqind më të larta se sa në tremujorin e dytë të vitit 2014. Të hyrat kufitare neto, të cilat përjashtojnë kthimet e doganës prej 1.0 milionë euro arritën vlerën prej 402.0 milionë euro. Të hyrat jo-tatimore arritën vlerën prej 23.0 milionë euro që paraqet një nivel të ngjashëm me vitin paraprak. Në anën tjetër, të hyrat vetanake (niveli qendror dhe lokal) shënuan rënie për 9.8 përqind duke arritur vlerën prej 46.0 milionë euro.

Sa i përket shpenzimeve, pagat e mëditjet dhe subvencionet e transferet shënuan rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa shpenzimet kapitale dhe mallrat e shërbimit shënuan rënie. Investimet kapitale, të cilat deri në qershor të vitit 2015 përfaqësuan rreth 17.6 përqind të gjithsej shpenzimeve, u zvogëluan në 116.0 nga 137.0 milionë euro që paraqet rënie prej 15.3 përqind. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime kanë shënuar rënie për 1.1 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 90.0 milionë euro. Në anën tjetër, shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje kanë shënuar rritje prej 10.7 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 258.0 milionë euro. Subvencionet dhe transferet po ashtu kanë shënuar rritje për 19.5 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 196.0 milionë euro. Rritja e këtyre dy kategorive në krahasim me vitin e kaluar i atribuohet faktit se vendimi qeverisë për rritjen e pagave dhe pensioneve i vitit të kaluar ka filluar të zbatohet pas tremujorit të parë të vitit 2014.

Deri në qershor 2015, vërehet një ekzekutim pothuajse i ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit 2014 (38.5 përqind e planit vjetor). Pagat dhe mëditjet si dhe subvencionet dhe transferet shënuan nivel të

ngjashëm të realizimit krahasuar me planin, ndërsa shpenzimet kapitale u realizuan në masën prej 24.1 përqind të planit vjetor krahasuar me shkallën prej 26.6 përqind të realizimit në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Poashtu, realizimi i të hyrave buxhetore i cili arriti nivelin prej 41.1 përqind të planit për vitin 2015, paraqet nivel të ngjashëm të realizimit krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Borxhi publik, në tremujorin e dytë të vitit 2015, ka arritur në 649.1 milionë euro nga 554.5 milionë euro sa ishte në tremujorin e dytë të vitit 2014, ndërsa si përqindje e PBB-së ka arritur në 11.2 përqind nga 10.3 përqind sa ishte në vitin paraprak. Kjo rritje prej 17.1 përqind e borxhit publik, i atribuohet kryesisht rritjes së borxhit të brendshëm ndërkohë që borxhi i jashtëm ka mbetur pothuajse i pandryshuar.


Sektori i Jashtëm

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015, deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka shënuar vlerën prej 224.3 milionë euro, krahasuar me vlerën prej 192.5 milionë euro sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ky përkeqësim kryesisht i atribuohet rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarisë së shërbimeve dhe të ardhurave parësore dhe dytësore. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015, deficiti në tregtinë e mallrave u karakterizua me një rritje vjetore prej 1.1 përqind nga periudha e njëjtë e vitit paraprak, përderisa llogaria e shërbimeve, të ardhurave parësore dhe të ardhurave dytësore u karakterizuan me zvogëlim të bilancit pozitiv për 3.4, 20.6 përkatësisht 0.5 përqind.

Gjithsej eksportet në qershor të vitit 2015 arritën vlerën 161.5 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 14.5 përqind (figura 38)⁵. Rritja e eksporteve gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet rritjes së eksporteve të plastikës dhe gomës, eksporteve të produkteve ushqimore si dhe rritjes së eksporteve të makinerive dhe pajisjeve elektrike.

Vlera e gjithsej importeve në Kosovë, deri në qershor të vitit 2015, arriti në 1.2 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5.1 përqind. Në kuadër të gjithsej importeve, me rritje u karakterizuan kategoria e produkteve ushqimore, importet e metaleve bazë, importet e plastikës dhe gomës dhe importet e mjeteve të transportit.

Figura 12. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar, në milionë euro



Burimi: ASK (2015)

Si rezultat i rritjes më të shpejtë të vlerës së eksporteve në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015, shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte u rrit në 13.5 përqind, nga 12.4 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.


Tregtia në shërbime u karakterizua me zvogëlim të bilancit pozitiv në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015.

⁵ Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është ASK, që është dhe prodhues zyrtar i këtyre statistikave.

Bilanci i shërbimeve shënoi vlerën prej 133.7 milionë euro në gjashtë muajt e parë të vitit 2015 (138.4 milionë euro deri në qershor 2014), përdërisa rënien më të madhe në kuadër të bilancit të shërbimeve e shënoi kategoria e shërbimeve kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit.

Kategoria më e madhe në kuadër të të hyrave të llogarisë së të ardhurave parësore mbeten të hyrat nga kompensimi i punonjësve, gjegjësisht të hyrat nga të ardhurat e punonjësve kosovarë jashtë vendit.⁶ Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015, të hyrat nga kompensimi i punonjësve shënuan rritje vjetore prej 5.4 përqind, duke arritur në 104.2 milionë euro.

Figura 13. Remitencat, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

Remitencat, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, vazhdojnë të kontribuojë në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Vlera e gjithsej remitencave të pranuar në vend deri në qershor 2015 arriti në 337.2 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 15.8 përqind.

⁶ Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të paguara për punëtorët jorezident në vend, apo të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Në këtë kontekst, përfshinë punëtorët sezonal apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitar të cilët qendrën e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.

Komponentë tjetër e rëndësishme në kuadër të bilancit të pagesave është edhe kategoria e Investimeve të Huaja Direkte (IHD). Bilanci i IHD-ve deri në qershor 2015 arriti në 163.6 milionë euro, që paraqet një rritje të konsiderueshme krahasuar me vlerën prej 39.1 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, me rritje të vlerës u karakterizuan të dy format e IHD-ve, përfshirë kapitalin dhe fondin e investimeve në aksione dhe investimet në instrumentet e borxhit (figura 4). Sektorët që përfituan më shumë nga rritja e IHD-ve ishin sektori i patundshmërive, qiradhënies dhe aktivitetëve tjera biznesore, si dhe sektori i shërbimeve financiare.

Figura 14. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

Sistemi Financiar

Në qershor 2015, vlera e gjithsej asetëve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 4.73 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 9.5 përqind. Kontributin kryesor në zgjerimin e aktivitetit të sistemit e kishin sektorët bankar dhe pensional krahas kontributit mesatar të sektorit të sigurimeve, përderisa efekti i sektorit mikrofinanciar dhe i

ndihmësve financiar, pavarësisht rritjes së aktivitetit të tyre, ishte i ulët (figura 15).

Figura 15. Asetet e sistemit financiar të Kosovës, në përqindje (qershor 2015)




Burimi: BQK (2015)

Sektori Bankar

Asetet

Sektori bankar në qershor 2015 regjistroi vlerë të asetëve prej 3.27 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6.9 përqind (9.8 përqind në qershor 2014) (figura 16). Ngadalësimi i rritjes së aktivitetit bankar krahasuar me vitin paraprak reflekton kryesisht ecurinë e depozitave si burim kryesor i financimit të sektorit.

Figura 16. Asetet e bankave komerciale, ndryshimet vjetore, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Struktura e asetëve të sektorit bankar edhe në qershor 2015 mbeti e dominuar nga kreditë, përkundër faktit që kjo kategori shënoi rënie të lehtë të pjesëmarrjes në strukturë krahasuar me vitin paraprak. Ishin kategoritë e parasë së gatshme dhe bilancit me BQK dhe letrave me vlerë ato të cilat shënuan rritje të lehtë të pjesëmarrjes në gjithsej asetet e sektorit. Ndërsa, pesha e kategorisë së bilancit me bankat komerciale mbeti e ngjashme me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Rritja e peshës së kategorisë së parasë së gatshme dhe bilancit me BQK-në reflekton rritjen e theksuar vjetore prej 11.0 përqind të kësaj kategorie në qershor 2015 (0.8 përqind në qershor 2014) kryesisht si rezultat i rritjes së rezervave të përgjithshme të bankave komerciale të mbajtura në BQK. Rritja e theksuar e parasë së gatshme dhe bilancit me BQK-në gjatë kësaj periudhe përkon me ngadalësimin e rritjes së investimeve në tregun e letrave me vlerë në sektorin e jashtëm.

Investimet në letra me vlerë të sektorit bankar arritën në 443.8 milionë euro në qershor 2015, duke shënuar rritje vjetore prej 9.5 përqind, dukshëm më të ulët se sa rritja prej 64.5 përqind e shënuar në vitin paraprak. Ky zhvillim ishte kryesisht si rezultat i rënies vjetore prej 5.7 përqind (rritje prej 62.4 përqind në qershor 2014) të investimeve në letra me vlerë të qeverive të huaja, të cilat edhe përbëjnë 50.7 përqind të portfolios së gjithsej investimeve. Rënia e theksuar është ndikuar kryesisht nga rënia e normave të interesit krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në anën tjetër, normat pozitive të interesit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës inkurajuan investimet në këto instrumente të cilat në qershor


2015 shënuan rritje vjetore prej 31.1 përqind, duke rritur pjesëmarrjen në 49.2 përqind të gjithsej portfolios së investimeve. Investimet në letrat me vlerë të korporatave tjera financiare dhe jo-financiare, që konsiderohen instrumente me shkallë më të lartë të rrezikut, vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të ulët në portfolion e investimeve (0.1 përqind në qershor 2015), duke treguar se bankat vazhdojnë të shmangin investimet me rrezik më të lartë.

Kategoria tjetër e asetëve e cila u karakterizua me rritje ishte ajo e bilancit me bankat tjera, që përfshinë depozitat dhe linjat kreditore në bankat jashtë vendit, e cila në qershor 2015 shënoi rritje prej 7.3 përqind (22.0 përqind në qershor 2014). Ngadalësimi i rritjes së kësaj kategorie ishte si rrjedhojë e zvogëlimit të theksuar të depozitave të afatizuara në valutën jo euro që mund të jetë ndikuar nga normat e ulta të interesit.

Kreditë

Sektorin bankar gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2015 tregoi shenja të përshpejtit të aktivitetit kreditues bankar. Në qershor 2015, vlera e gjithsej kredive arriti në 2.01 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 6.1 përqind (3.5 përqind në qershor 2014) (figura 17).


Figura 17. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Rritja e përshpejtuar e kreditimit bankar, e shprehur si te kreditë ndaj ndërmarrjeve ashtu edhe në ato ndaj ekonomive familjare, përkon me trendin rënës të normave të interesit në kredi dhe me lehtësimin e standardeve dhe kushteve të kreditimit nga bankat. Kreditë për ndërmarrjet, në qershor 2015 shënuan rritje vjetore të përshpejtuar prej 5.2 përqind (2.9 përqind në qershor 2014). Megjithatë, kontributin kryesor në përshpejtimin e gjithsej kredive e kishin kreditë për ekonomitë familjare, të cilat shënuan rritje vjetore prej 11.4 përqind (5.6 përqind në qershor 2014) (figura 18).


Figura 18. Vlerat dhe ndryshimet vjetore të kredive, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike mbetet e kryesuar nga kreditë e destinuar për tregti (me pjesëmarrje prej 54.0 përqind), pasuar nga ato për prodhimtari (me 12.6 përqind) dhe ndërtimtari (me 7.7 përqind). Sektori i bujqësisë vazhdon të ketë çasje më të ulët në financimin bankar (me pjesëmarrje prej 3.8 përqind) (figura 19).


Figura 19. Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje (qershor 2015)



Burimi: BQK (2015)

Sa i përket tendencave të fundit të kreditimit të sektorëve ekonomik, gjatë gjashtëmujorit të parë 2015, kreditimi i të gjithë sektorëve të ekonomisë shënoi rritje, përjashtuar sektorin e ndërtimtarisë i cili vazhdon të karakterizohet me rënie të kreditimit. Rritjen më të theksuar e regjistroi kreditimi i sektorit të bujqësisë i cili në qershor 2015 shënoi rritje vjetore prej 12.2 përqind, krahasuar me rënie prej 5.6 përqind në qershor 2014. Përmirësimi i theksuar i ecurisë së kreditimi të bujqësisë është rrjedhojë e uljes së normave të interesit të ofruara nga bankat dhe rritjes së numrit të bizneseve të reja në këtë sektor.

Figura 20. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2015)

Kreditimi i sektorit të tregtisë pas tri viteve të ngadalësimit të rritjes, në qershor 2015 shënoi rritje të theksuar prej 8.8 përqind (1.0 në qershor 2014). Përshpejtimi mes tjerash, reflekton edhe rritjen e aktivitetit tregtar të Kosovës me vendet tjera në eksportimin dhe importimin e mallrave. Faktor tjetër kontribues ishte edhe numri i madh i bizneseve të reja të regjistruara në sektor krahas veprimtarive tjera, që mund të jetë indikator i rritjes së kërkesës për kreditim të sektorit.


Sektori i prodhimit, në qershor 2015 u karakterizua me rritje vjetore të kreditimit prej 10.6 përqind (16.9 përqind në qershor 2014) (figura 20). Fakti që sektori ende regjistron normë dyshifrore të rritjes mbështet ecurinë pozitive të sektorit të prodhimit të shprehur përmes indeksit të qarkullimit industrial (industria përpunuese).

Në anën tjetër, përkundër rënies së normave të interesit dhe lehtësimit të standardeve të kreditimit nga ana e bankave, sektori i ndërtimit vazhdon të shënoj rënie edhe pse shkalla e rënies ishte më e zbutur vitin e fundit. Në qershor 2015, kreditimi i ndërtimit regjistroi rënie vjetore prej 9.0 përqind (rënie prej 10.3 përqind në qershor 2014). Trendi

rënës i kreditimit të këtij sektori reflekton kryesisht rënien e kërkesës si rezultat i shtrëngimit të standardeve dhe kushteve në dhënien e lejeve ndërtimore gjatë dy viteve të fundit.

Sipas afatit të maturimit, struktura e gjithsej kredive vazhdon të dominohet nga kreditë afatmesme, gjegjësisht kreditë me afat ‘mbi 1 deri në 5 vite’ (figura 21). Megjithatë, krahasuar me periudhën e kaluar, vërehet një rënie e pjesëmarrjes së kredive afatshkurtëra (‘deri në 1 vit’) dhe rritje e pjesëmarrjes së kredive afatgjata (‘mbi 5 vite’). Rritja e pjesëmarrjes së kredive afatgjata reflekton edhe zgjatjen e maturimit të kredive si masë lehtësuese.

Figura 21. Struktura e maturimit të kredive



Burimi: BQK (2015)

Aktiviteti kreditues i sektorit bankar u karakterizua me ritëm të përshpejtuar të rritjes gjatë gjashtëmuajorit të parë 2015. Kreditë për ndërmarrje që gjatë tri viteve të fundin shënuan rritje të ngadalësuar, në qershor 2015 shënuan rritje të përshpejtuar, mirëpo kreditë për ekonomitë familjare kishin kontributin kryesor në zgjerimin e gjithsej aktivitetit kreditues.

Detyrimet

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar vazhdon të kryesohet nga depozitat, që paraqesin burimin kryesor të financimit për bankat komerciale. Mbështetja e lartë në depozita të cilat konsiderohen burim i qëndrueshëm i financimit eviton ekspozimin e sektorit ndaj lëvizjeve në tregjet e jashtme. Mirëpo, si rezultat i varësisë së lartë zhvillimet në depozita janë edhe përcaktuesi kryesor i rritjes së aktivitetit të sektorit bankar.

Mjetet vetanake, si kategoria e dytë për nga pjesëmarrja në gjithsej detyrimet e sektorit, në qershor 2015 shënuan rritje vjetore prej 20.6 përqind (6.2 përqind në qershor 2014). Kjo rritje ishte si rezultat i rritjes rekorde të profitit të realizuar gjatë vitit të kaluar, që po karakterizon sektorin bankar edhe gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2015.


Kategoria e cila shënoi rritjen më të lartë në kuadër të detyrimeve ishte bilanci nga bankat tjera e cila regjistroi rritje vjetore prej 86.0 përqind në qershor 2015. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i nevojave të disa bankave për mjete shtesë me kohëzgjatje të shkurtër maturimi, kryesisht të huazuara nga bankat tjera apo bankat amë, për të zhvilluar normalisht aktivitetin e tyre. Në anën tjetër, kategoria e huazimeve tjera (përfshirë çertifikatat e depozitave) shënoi rënie vjetore prej 27.2 përqind në qershor 2015.

Depozitat

Gjithsej depozitat në sektorin bankar të Kosovës në qershor 2015 arritën vlerën prej 2.57 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 6.3 përqind (10.0 përqind në qershor 2014) (figura 22). Krahasuar me

vitin paraprak kemi ngadalësim të rritjes që u reflektua edhe në ecurinë e gjithsej aktivitetit të sektorit bankar. Normat e ulëta të interesit në depozita (veçanërisht atyre të ekonomive familjare) që po karakterizojnë sektorin bankar kanë kontributin më të lartë në ngadalësimin e rritjes së depozitave.


Figura 22. Ndryshimi vjetor i depozitave në bankat komerciale, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Struktura e depozitave në sektorin bankar vazhdon të dominohet nga depozitat e ekonomive familjare, të cilat përbëjnë 74.0 përqind të gjithsej depozitave. Kategoria e dytë për nga pesha në strukturë është ajo e depozitave të ndërmarrjeve me pjesëmarrje prej 20.9 përqind në gjithsej depozitat (figura 23).


Figura 23. Struktura e depozitave në bankat komerciale



Burimi: BQK (2015)

Në qershor 2015 norma vjetore e rritjes së depozitave të ekonomive familjare ishte 6.0 përqind (9.1 përqind në qershor 2014). Ky ngadalësim i rritjes përkon me normat e ulëta të interesit në depozita që po e karakterizojnë sektorin bankar që nga tremujori i dytë i vitit 2014.

Figura 24. Struktura depozitave sipas maturimit, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Normë më të ulët të rritjes krahasuar me vitin paraprak, po ashtu shënuan depozitat e ndërmarrjeve, të cilat në qershor 2015 shënuan rritje vjetore prej 7.3 përqind (11.9 përqind në qershor 2014) dhe depozitat tjera (depozitat e jo-rezidentëve, organizatave jo-qeveritare, etj.) të cilat shënuan rritje vjetore prej 7.9 përqind në qershor 2015 (15.0 përqind në qershor 2014).

Struktura e depozitave sipas maturimit ka pësuar ndryshime të mëdha krahasuar me vitin paraprak. Në qershor 2015, pjesa më e madhe e depozitave ishin në formë të depozitave të transferueshme, të cilat përbënë 50.1 përqind të gjithsej depozitave. Depozitat e afatizuara përbënë 28.4 përqind ndërsa ato të kursimit 21.5 përqind (figura 24). Zvogëlimi i theksuar i pjesëmarrjes së depozitave të afatizuara në strukturën e gjithsej depozitave përkon me normat

mjaft të ulëta të interesit në depozita që mund të kenë dekurajuar afatizimin e depozitave.

Figura 25. Struktura e depozitave të afatizuara



Burimi: BQK (2015)


Në kuadër të strukturës së depozitave të afatizuara, në periudhën raportuese vihet re një rritje në pjesëmarrje të depozitave me afat të gjatë maturimi ‘mbi 2 vite’ dhe në ato afatmesme ‘mbi 1 deri në 2 vite’. Ndërsa, depozitat afatshkurta ‘deri 1 vit’ kanë zvogëluar pjesëmarrjen në strukturën e depozitave të afatizuara (figura 23). Këto lëvizje janë ndikuar nga normat e interesit, të cilat janë më të larta në depozitat me afat më të gjatë maturimi krahasuar me ato afatshkurta.

Në qershor 2015, depozitat vazhduan të shënojnë rritje por me ritëm më të ngadalshëm krahasuar me vitin paraprak. Kapitali vetanak shënoi rritje të theksuar në qershor 2015 kryesisht si rezultat i rritjes rekorde të profitit të sektorit bankar gjatë kësaj periudhe.

Normat e Interesit

Normat e interesit në kredi vazhduan me trendin rënës të ndjekur gjatë viteve të fundit, përderisa normat në depozita shënuan rritje të lehtë në krahasim me vitin paraprak.

Figura 26. Mesatarja e normave të interesit, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Në qershor 2015, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëlua në 7.6 përqind nga 10.6 përqind sa ishte në qershor 2014. Rënia mund të jetë ndikuar nga presioni i konkurrencës bankare dhe zvogëlimit të kostos së financimit të aktivitetit bankar krahasuar me vitet e kaluara. Në depozita, norma mesatare e interesit u rrit në 0.8 përqind nga 0.6 përqind sa ishte në qershor 2014. Normat e ulëta të interesit në depozita janë kryesisht rrjedhojë e prezencës së mjaftueshme të likuiditetit në sektorin bankar. Përfundimisht, dallimi në mes të normës së interesit në kredi dhe depozita në qershor 2015, u zvogëlua në 6.8 përqind nga 10.0 përqind sa ishte në qershor 2014 (figura 26).

Trendi rënës i normave të interesit në kredi është shprehur si në kreditë ndaj ndërmarrjeve, ashtu edhe në ato ndaj ekonomive familjare. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në qershor 2015 u zvogëlua në 7.4 përqind nga 10.5 përqind sa ishte në qershor 2014. Në kuadër të ndërmarrjeve, rënia më e theksuar u shënuar në kreditë investuese me maturim ‘mbi 1 vit’, të cilat në qershor 2015

zbritën në 7.1 përqind nga 10.4 përqind në qershor 2014 (figura 27).


Figura 27. Normat mesatare të interesit për kreditë e ndërmarrjeve, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Sipas veprimtarisë ekonomike, rënia e normës së interesit ishte më e theksuar në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë dhe industrisë. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë u zvogëlua në 10.5 përqind në qershor 2015 (14.2 përqind në qershor 2014), ndërsa për sektorin e industrisë u zvogëlua në 7.7 përqind (11.3 përqind në qershor 2014). Sektori i shërbimeve vazhdon të ketë normën më të ulët të interesit në kredi prej 7.2 përqind në qershor 2015 (10.2 në qershor 2014).


Figura 28. Normat mesatare të interesit për kreditë e ekonomive familjare, në përqind



Burimi: BQK (2015)

Në qershor 2015, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare u zvogëluar në 8.2 përqind, nga 10.8 përqind sa ishte në qershor 2014. Sipas qëllimit të përdorimit, normat e interesit në kreditë konsumuese shënuan rënien më të madhe në 8.4 përqind në qershor 2015 (10.9 përqind në qershor 2014), përderisa norma e interesit për kreditë hipotekare u zvogëluar në 7.3 përqind (9.5 përqind në qershor 2014) (figura 28).

Figura 29. Normat mesatare të interesit për depozita, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Sa i përket normave të interesit në depozita, vërehet rritje si në depozitat e ndërmarrjeve ashtu edhe në ato të ekonomive familjare. Në kuadër të depozitave të ndërmarrjeve normat e interesit shënuan rritje në 1.0 përqind nga 0.3 përqind sa ishin në qershor 2014. Normat e interesit në depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje në 0.8 përqind nga 0.6 përqind sa ishin në qershor 2014.

Performanca e sektorit bankar

Sektori bankar në dy vitet e fundit po karakterizohet me performancë të shkëlqyer financiare. Neto profiti i realizuar deri në qershor 2015 shënoi vlerën 46.2 milionë euro, krahasuar me vlerën prej 26.9 milionë euro të regjistruar deri në qershor 2014. Rritja e


profitit është kryesisht rezultat i zvogëlimit të theksuar të shpenzimeve, përderisa të hyrat shënuan rënie të lehtë.

Të hyrat e sektorit bankar deri në qershor 2015 arritën vlerën 119.7 milionë euro dhe shënuan rënie vjetore prej 1.5 përqind. Kategoria e të hyrave nga interesi vazhdon të dominoj strukturën e të hyrave me 78.8 përqind, përderisa të hyrat nga jo-interesi përbëjnë 20.6 përqind të strukturës, dhe pjesa e mbetur përfaqësohet nga të hyrat nga rivlerësimi.

Deri në qershor 2015, të hyrat nga interesi shënuan rënie vjetore prej 2.9 përqind. Kjo rënie i atribuohet zvogëlimit të të hyrave nga interesi në kredi kryesisht si rrjedhojë e rënies së normave të interesit. Të hyrat nga jo-interesi deri në qershor 2015 shënuan rritje vjetore prej 1.8 përqind si rezultat i rritjes së të ardhurave tjera operative. Kurse, të hyrat nga tarifat dhe komisionet në kuadër të hyrave nga jo-interesi qëndruan në nivel të ngjashëm me vitin e kaluar.

Vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar deri në qershor 2015 arriti në 73.5 milionë euro, e cila është për 22.4 përqind më e ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Zvogëlimi i gjithsej shpenzimeve në masë të madhe ishte rezultat i reduktimit të shpenzimeve të interesit, që shënuan rënie vjetore prej 53.0 përqind. Në kuadër të shpenzimeve të interesit, shpenzimet për interesin në depozita shënuan rënie vjetore prej 50.6 përqind, që kryesisht reflekton zvogëlimin e normës së interesit në depozita.

Figura 30. Të hyrat dhe shpenzimet e bankave komerciale, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

Gjithashtu, kontribut në zvogëlimin e gjithsej shpenzimeve kishte edhe reduktimi i shpenzimeve të jo-interesit, të cilat shënuan rënie vjetore prej 58.7 përqind. Në kuadër të tyre, rënien më të madhe vjetore prej 85.7 përqind shënuan shpenzimet për provizione. Rënia e vlerës së gjithsej kredive jo-performuese ka ndikuar në ndarjen më të ulët të provizioneve për humbjet e mundshme nga kreditë. Ndërsa, shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, që përfaqësojnë pjesën më të madhe të gjithsej shpenzimeve, shënuan një rritje vjetore prej 2.2 përqind deri në qershor 2015.

Pavarësisht rënies së lehtë së të hyrave, zvogëlimi i theksuar i shpenzimeve ka ndikuar që raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit bankar të përmirësohet dukshëm. Në qershor 2015, ky indikator u zvogëlua në 61.4 përqind, krahasuar me 77.9 përqind sa ishte deri në qershor 2014 (figura 30). Po ashtu, profiti i realizuar deri në qershor 2015 ka ndikuar në përmirësimin e mëtutjeshëm të indikatorëve të profitabilitetit siç janë Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE). ROAA u përmirësua

në 2.8 përqind, nga 1.9 përqind sa ishte në 2014, përderisa ROAE u përmirësua në 26.7 përqind, nga 20.2 përqind sa ishte në 2014 (figura 31).⁷

Figura 31. Treguesit e profitabilitetit



Për 2015 treguesit e profitabilitetit janë llogaritur duke u bazuar në performancën deri në Qershor 2015

Burimi: BQK (2015)

Profiti i sektorit bankar ka vazhduar të rritet edhe gjatë gjashtëmuajt të parë 2015. Zvogëlimi i theksuar i shpenzimeve të interesit dhe atyre për provizione, paraqesin kontribuesit kryesor në zvogëlimin e gjithsej shpenzimeve, rrjedhimisht rritjen e profitit të sektorit bankar. Në anën tjetër, të hyrat shënuan rënie të lehtë si rezultat i rënies së të hyrave nga interesi në kredi.


Treguesit e shëndetit financiar

Niveli i ulët i kredive jo performuese dhe mbulueshmëria në nivel të kënaqshëm me provizione vazhdon të jetë karakteristikë e sektorit bankar.

Në qershor 2015, pjesëmarrja e kredive jo performuese në gjithsej kreditë u zvogëlua në 7.2 përqind nga 8.2 përqind sa ishte në qershor 2014 (figura 32). Në rënien e normës së NPL-ve mund të ketë ndikuar përsheptimi i rritjes së gjithsej kreditimit gjatë kësaj periudhe mirëpo edhe rënia

⁷ ROAA dhe ROAE për vitin 2015 janë të aktualizuara me performancën e sektorit bankar deri në qershor 2015.

Figura 32. NPL dhe provizionet për humbje nga kreditë, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

vjetore prej 6.2 përqind e vlerës së kredive jo performuese (figura 33). Mbulueshmëria me provizione e kredive jo performuese në qershor 2015 u përmirësua në 119.3 përqind krahasuar me 116.4 përqind në qershor 2014.

Sektori bankar vazhdon të ketë nivel të mirë të kapitalizimit. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (CAR) arriti në 19.0 përqind në qershor 2015 nga 17.4 përqind sa ishte në qershor 2014. Përforcimi i kapitalizimit të sektorit bankar kryesisht i atribuohet profitit të realizuar nga bankat në vitin 2014 si dhe fitimit të akumuluar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2015. Sektori bankar vazhdon të ketë pozicion të kënaqshëm të likuiditetit. Në qershor 2015, raporti i kredive ndaj depozitave ishte 77.9 përqind, kurse raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra qëndroi në 41.9 përqind në qershor 2015.⁸

Figura 33. Rritja vjetore e gjithsej kredive dhe kredive joperformuese, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Sektori pensional

Vlera e aseteve të sektorit pensional në qershor 2015 arriti në 1.18 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 18.1 përqind (figura 34).

Figura 34. Asetet e fondeve pensionale dhe rritja vjetore



Burimi: BQK (2015)

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) vazhdon të përfaqësoj pjesën më të madhe të aseteve të sektorit (99.5 përqind), ndërsa pjesa e mbetur (0.5 përqind) menaxhohet nga Fondi Slloveno–Kosovar i Pensioneve (FSKP).

Asetet e FKPK-së gjatë gjashtëmujorit të parë 2015 vazhduan të rriten si rezultat i arkëtimeve të reja të kontributeve pensionale dhe kthimit pozitiv në

⁸ Rregullorja përkatëse e BQK-së kërkon që raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra të mos jetë më i ulët se 25 përqind.


investime. Në qershor 2015, vlera e gjithsej aseteve të FKPK-së arriti në 1.18 miliardë euro që përkon me rritje vjetore prej 18.2 përqind. Vlera e kontributeve të arkëtuara deri në qershor 2015 arriti në 57.7 milionë euro me rreth 490.0 mijë kontribues. Deri në qershor 2015, FKPK ka realizuar 37.5 milionë euro kthim bruto nga investimet krahasuar me 31.9 milionë euro në qershor 2014. Në ditën e fundit të muajit qershor 2015, çmimi i aksionit arriti në 1.33 euro (1.25 euro në qershor 2014).

Gjithashtu, edhe FSKP-ja u karakterizua me rritje të aktivitetit dhe performancës pozitive në gjashtëmuajorin e parë 2015. Në qershor 2015, vlera e gjithsej aseteve të FSKP-së arriti në 6.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 6.5 përqind. Rritja kryesisht i atribuohet kthimit nga investimet, që deri në qershor 2015 arriti në 164.8 mijë euro (241.3 mijë euro deri në qershor 2014). Në ditën e fundit të qershorit 2015, çmimi i aksionit të FSKP-së arriti në 147.89 euro (143.84 euro në qershor 2014).⁹

Sektori mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar gjatë gjysmës së parë të vitit 2015 u karakterizua me zgjerim të aktivitetit ku vlera e aseteve të sektorit në qershor 2015 arriti në 116.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 2.8 përqind (0.2 përqind në qershor 2014) (figura 35).

Figura 35. Asetet e institucioneve mikrofinanciare dhe rritja vjetore



Burimi: BQK (2015)

Kreditimi mikrofinanciar gjithashtu u karakterizua me zgjerim, ku vlera e gjithsej kredive të sektorit arriti në 77.9 milionë euro në qershor 2015, rritje vjetore prej 2.8 përqind (2.0 përqind në qershor 2014). Zgjerimi reflekton rritjen e kredive ndaj ndërmarrjeve, të cilat shënuan rritje vjetore prej 9.4 përqind në qershor 2015, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rënie vjetore prej 0.4 përqind. Faktor kontribues në rënien e kreditimit ndaj ekonomive familjare mund të jetë konkurrenca prej sektorit bankar i cili zgjeroi dukshëm kreditimin ndaj ekonomive familjare gjatë kësaj periudhe.


Kreditimi i sektorit mikrofinanciar sipas sektorëve ekonomik, u karakterizuan me rritje në pothuajse të gjitha kategoritë. Kreditë ndaj sektorit të shërbimeve të cilat përbëjnë 45.2 përqind të gjithsej kredive, u karakterizuan me rritje vjetore prej 7.5 përqind (7.2 përqind në qershor 2014). Kreditë ndaj sektorit të industrisë, të cilat janë kategoria e dytë për nga pesha, shënuan rritjen më të theksuar vjetore prej 23.3 përqind në qershor 2015 (0.4 përqind në qershor 2014). Në kuadër të sektorit të industrisë, kreditë për ndërtimtari u karakterizuan me rritje vjetore prej

⁹ Vlera bazë e aksionit të FSKP-së është 100 për dallim nga ajo e FKPK-së që është 1.

23.2 përqind në qershor 2015, për dallim nga sektori bankar ku kreditimi i kësaj veprimtarie vazhdon të zvogëlohet. Me rënie të lehtë të kreditimit u karakterizuan kreditë ndaj bujqësisë, të cilat shënuan rënie vjetore prej 0.7 përqind në qershor 2015 (rritje vjetore prej 1.0 përqind në qershor 2014).

Struktura e kredive të sektorit sipas afatit të maturimit vazhdon të jetë e dominuar nga kreditë me afat të mesëm maturimi. Në qershor 2015, kreditë me afat maturimi ‘mbi 1 deri 5 vite’ kishin një pjesëmarrje prej 84.1 përqind në gjithsej kreditë, pasuar nga ato me maturim ‘deri 1 vit’ me 15.6 përqind dhe ‘mbi 5 vite’ me 0.3 përqind (figura 36).

Figura 36. Struktura e kredive të institucioneve mikrofinanciare sipas maturitetit, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Vlera e gjithsej lizingjeve të sektorit mikrofinanciar arriti në 23.0 milionë euro në qershor 2015, duke shënuar një rritje vjetore prej 2.0 përqind. Lizingjet për ekonomitë familjare u karakterizuan me rritje vjetore prej 64.8 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së lizingut hipotekar. Ndërsa, lizingjet për ndërmarrje shënuan rënie vjetore prej 27.6 përqind në qershor 2015 kryesisht si rrjedhojë e zvogëlimit të lizingut financiar – kredive hipotekare, dhe lizingut për blerjen e pajisjeve.


Zgjerimi i aktivitetit kreditues të sektorit u mbështet nga rritja e huazimeve prej sektorit të jashtëm, që përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të aktivitetit të këtij sektori. Në qershor 2015, gjithsej huazimet arritën vlerën prej 84.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 1.2 përqind (rritje prej 0.9 përqind në qershor 2014).

Institucionet mikrofinanciare vazhdojnë të karakterizohen me nivel të ulët të kredive jo performuese dhe nivel të kënaqshëm të provizioneve për mbulimin e kësaj kategorie të kredive. Në qershor 2015, pjesëmarrja e kredive jo performuese në gjithsej kreditë u përmirësua në 5.4 përqind, në krahasim me normën prej 5.9 përqind sa ishte në qershor 2014. Gjithashtu, edhe mbulueshmëria e kredive jo performuese me provizione u përmirësua në 109.5 përqind në qershor 2015 krahasuar me nivelin prej 106.9 përqind në qershor 2014.

Sektori mikrofinanciar vazhdon të karakterizohet me norma më të larta të interesit në kredi, në krahasim me sektorin bankar. Mesatarja e normës efektive të interesit në kreditë e lëshuara në qershor 2015 ishte 24.2 përqind (25.2 përqind në qershor 2014).

Mesatarja e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare në qershor 2015 ishte 24.6 përqind nga 25.3 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kurse, mesatarja e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në qershor 2015 ishte 23.5 përqind krahasuar me mesataren prej 24.6 përqind sa ishte në qershor 2014 (figura 37).

Figura 37. Mesatarja e normave të interesit në kredi të institucioneve mikrofinanciare, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të shërbimeve dhe bujqësisë në qershor 2015 u zvogëlua në 23.7 përqind përkatësisht 25.2 përqind (26.1 përqind, përkatësisht 25.6 përqind në qershor 2014). Kurse, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të industrisë u rrit në 23.4 përqind nga 22.4 përqind në qershor 2014. Zvogëlimi i normave të interesit për sektorin e shërbimeve mund të ketë pasur efekt pozitiv në rritjen e kreditimit për këtë sektor ekonomik, gjë e cila nuk u reflektua edhe në kreditë për sektorin e bujqësisë.

Sektori mikrofinanciar deri në qershor 2015 realizoi profit në vlerë prej 1.2 milionë euro krahasuar me humbjen prej 13.6 mijë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Operimi me fitim ishte rezultat i rritjes më të shpejtë të të hyrave krahasuar me rënien më të ngadalësuar të shpenzimeve.

Deri në qershor 2015, sektori realizoi të hyra në vlerë prej 10.0 milionë euro, që paraqet rritje vjetore të konsiderueshme prej 7.1 përqind krahasuar me rënien prej 4.8 përqind të shënuar deri në qershor

2014. Kjo ishte kryesisht rezultat i rritjes së të hyrave nga interesi, që shënuan rritje vjetore prej 8.6 përqind në qershor 2015. Në anën tjetër, shpenzimet arritën vlerën prej 8.8 milionë euro deri në qershor 2015 duke shënuar rënie vjetore prej 5.6 përqind. Rënia ishte kryesisht si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve për provizionet për humbjet e mundshme nga kreditë.


Rrjedhimisht, Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) u përmirësua në 2.1 përqind (1.1 përqind në vitin 2014), ndërsa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE) u përmirësua në 7.7 përqind (4.3 përqind në vitin 2014).¹⁰

Sektori i sigurimeve

Gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve në qershor 2015 shënuan rritje vjetore prej 11.5 përqind, duke arritur vlerën 151.2 milionë euro (figura 38). Kjo rritje ndër tjerash ishte si rezultat i licensimit të dy kompanive të reja të cilat ofrojnë shërbime të jo-jetës. Sigurimet jo-jetë vazhdojnë të përfaqësojnë pjesën më të madhe të asetëve të sektorit (90.2 përqind), ndërsa pjesa e mbetur (9.8 përqind) menaxhohet nga sigurimet jetë.

¹⁰ ROAA dhe ROAE për vitin 2015 janë të aktualizuara me performancën e sektorit deri në qershor 2015.

Figura 38. Asetet e kompanive të sigurimit dhe rritja vjetore



Burimi: BQK (2015)

Ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, vlera e primeve të shkruara deri në qershor 2015 arriti në 40.3 milionë euro, nga të cilat 38.9 milionë euro përfaqësojnë sigurimin jo-jetë, ndërsa 1.4 milionë euro sigurimin jetë. Vlera totale e dëmeve të paguara deri në qershor 2015 arriti në 19.5 milionë euro, prej të cilave 12.3 milionë euro janë dëme të paguara në kuadër të sigurimit të përgjegjësive ndaj palës së tretë.

Deri në qershor 2015, sektori i sigurimeve regjistroi humbje në vlerë prej 2.5 milionë euro, krahasuar me humbjen prej 113.2 mijë euro të vitit paraprak. Thellimi i humbjes së sektorit reflekton kryesisht përkeqësimin e performancës financiare të një kompanie e cila me kërkesë të BQK-së është rikapitalizuar menjëherë me datën 1 korrik 2015. Sigurimi jo-jetë vazhdon të karakterizohet me humbje krahas performancës pozitive financiare të sigurimit jetë. Deri në qershor 2015, sigurimi jo-jetë kishte humbje të theksuara prej 2.8 milionë euro (316.0 mijë euro në qershor 2014) krahas, sigurimi jetë i cili regjistroi profit në vlerë prej 236.3 mijë euro nga 429.2 mijë euro deri në qershor 2014.

Performanca financiare e sektorit ndikoi në përkeqësimin e mëtutjeshëm të indikatorëve të profitabilitetit siç janë Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE). ROAA u përkeqësua në -3.6 përqind (-0.2 përqind në vitin 2014) kurse ROAE në -10.2 përqind (-0.7 përqind në vitin 2014).¹¹

Sektori pensional vazhdoi të ketë performancë të mirë financiare dhe zgjerim të aktivitetit. Sektori mikrofinanciar u karakterizua me rritje të aktivitetit dhe rritje të profitit gjatë kësaj periudhe. Kurse, sektori i sigurimeve shënoi rritje të aktivitetit, mirëpo u karakterizua me performancë jo të mirë financiare si rezultat i rritjes së shpenzimeve për dëmet e ndodhura.

Tregu i letrave me vlerë


Gjatë periudhës janar-qershor 2015, Qeveria e Kosovës emetoi letra me vlerë në shumë prej 215.0 milionë euro, 7 milionë euro më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Megjithatë, gjatë kësaj periudhe për herë të parë Qeveria filloi me emetimin e letrave me vlerë me afat maturimi tre vjeçar. Kalendari i publikuar për letra me vlerë deri në qershor 2015, ka pasur gjithsej 11 ankande, prej të cilave, dy me afat maturimi 91 ditë, dy me afat maturimi 182 ditë, katër me afat maturimi 364 ditë, dy ankande me afat maturimi dy vjeçar dhe një ankand me afat maturimi tre vjeçar.

Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, sipas maturitetit ka pësuar ndryshime krahasuar me vitet

¹¹ ROAA dhe ROAE të anualizuara me performancën e sektorit deri në qershor 2015

e kaluara. Gjatë tri viteve të fundit vërehet një zhvendosje drejt letrave me vlerë afatgjata (figura 39).

Figura 39. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Kjo zhvendosje, është rezultat i ofertës, përkatësisht Qeverisë së Kosovës, e cila ka rritur numrin dhe vlerën e ankandëve të letrave me vlerë me afat më të gjatë maturimi kundrejt zvogëlimit të atyre me afat më të shkurtër maturimi.

Që nga themelimi i tregut të letrave me vlerë në vitin 2012, shumën e ofertuar vazhdimisht ka tejkaluar shumën e shpallur në ankandë prej Departamentit të Thesarit në kuadër të Ministrisë së Financave. Në qershor 2015, raporti në mes të shumës së ofertuar dhe asaj të shpallur në ankandë ishte 1.5 herë më i lartë (1.6 herë më i lartë në qershor 2014). Ngadalësimi i rritjes së depozitave në njërin anë si dhe rritja e përshpejtuar e aktivitetit kreditues nga sektori bankar mund të kenë ndikuar në zvogëlimin e raportit të shumës së ofertuar ndaj asaj të shpallur për letra me vlerë. Ndikim të ngjashëm mund të ketë pasur edhe zhvendosja e një pjese të konsiderueshme të mjeteve të FKPK-së në sektorin e jashtëm. Në qershor 2015 vetëm 10.5 përqind e aseteve të FKPK-

së ishin të investuara në vend kundrejt 24.6 përqind në qershor 2014.

Figura 40. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë, në periudhën janar-qershor 2015 ishte më e lartë (1.8 përqind) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (1.3 përqind). Zhvendosja e emetimit të letrave drejt atyre me maturim afatgjatë ka ndikuar që norma mesatare e interesit gjatë kësaj periudhe të jetë më e lartë krahasuar me periudhën paraprake (figura 40).

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2015): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 11 TM2 2015, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2015):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,129>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,163>

ASK (2015):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit, qasur në mars 2015: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit, qasur në mars 2015: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-
- c) Indeksi i çmimeve të importit, qasur në mars 2015: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike, qasur në mars 2015: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat ë tregtisë së jashtme, qasur në mars 2015: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2015): Metal Prices database, qasur në mars 2015.

FAO (2015): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: qasur në mars 2015: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2015): Euribor Historical Rates, qasur në mars 2015:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2015): World Economic Outlook: qasur në mars 2015:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2013/02/weodata/index.aspx>

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2014/update/01/pdf/0114.pdf>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Qershor 2014	Qershor 2015
Sektori real 1/		
PBB (në milionë euro)	-	-
Çmimet (mesatarja vjetore)	0.3%	-0.4%
Çmimet (fondi i periudhës)	0.4%	-0.5%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat (në milionë euro)	603.0	647.0
Shpenzimet (në milionë euro)	625.0	660.0
Bilanci, si përqindje e PBB-së	-	-
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	4,311.7	4,722.2
prej të cilave: Bankat	3,059.5	3,269.6
Kredi	1,889.9	2,005.2
Depozita	2,421.0	2,574.6
Norma e interesit në kredi, fundi i periudhës	10.6	7.6
Norma e interesit në depozita, fundi i periudhës	0.6	0.8
Hendeku i normës së interesit	10.0	6.8
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/	Shtator 2013	Shtator 2014
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-136.3	-158.5
prej të cilave: remitencat e pranuar	235.3	279.9
Llogaria financiare	-48.1	-93.4
Investimet e huaj direkte në Kosovë	29.1	157.7
Investimet portfolio, net	58.1	63.7
Investimet tjera, net	-6.2	-29.1
Pozicioni ndërkombëtar i Investimeve, net*	401.9	383.6
Asetet	4,172.4	4,419.6
Detyrimet	3,770.5	4,036.0
Borxhi i jashtëm, gjithsej	1,596.8	1,736.8
Borxhi i jashtëm privat	1,217.0	1,336.4
Borxhi i jashtëm publik	379.8	400.4

Burimi:

1/ ASK (2015).

2/ MF (2015).

3/ BQK (2015).

*Për PNI, të dhënat janë për tremujorin e parë të viteve përkatëse.

